




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Drejtoria për Arsim në Deçan

07 nr..9031

Deçan, dt.15.04.2014

Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 8 pika 1 dhe 2 të Ligjit të punës nr.03 / L-212 , Ligjit për Arsimin Parauniversitar nr.04/ L-032 , dispozitave të nenit 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr.03/ L-068, si dhe mbështetur në dispozitat ligjore të Udhëzimit Administrativ mbi procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Institucionit edukativo – arsimor dhe aftësues nr.08/ 2014 , Drejtoria për Arsim në Deçan, shpallë :

K O N K U R S

Për zgjedhjen e drejtorit të Institucionit edukativo – arsimor dhe aftësues në :
Gjimnazin ‘ ‘ **Vëllezërit Frashëri** ‘ ‘ – Deçan

1. Drejtor shkolle

KUSHTET : Kandidatët e interesuar për të konkurruar për drejtor në këtë shkollë duhet t'i plotësojnë këto kushte

- 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- 1.2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECT 4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore.
- 1.3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit.
2. Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim.
3. Të kenë së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit

4. Të posedojnë këto dokumente :

- 4.1. Çertifikatën e lindjes;
- 4.2. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- 4.3. Dëshminë për përvojën e punës;
- 4.4. Portfolion profesionale (CV);
- 4.5. Letërreferencë nga një institucion publik –kredibil (si MASHT, DKA. Këshilli Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë;
- 4.6. Letrat e references duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake.
- 4.7. Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fondi shkronjave 12 Arial) sipas udhëzimeve të MASHT.

- 4.8. Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij-saj shëndetësore.
- 4.9. Dëshminë se nuk është nën hetime.
- Marrëdhënia e punës krijohet përmes kontratës në pajtim me ligjet dhe zgjatë 4 vjet.
- Kandidatët e interesuar për konkurrim gëzojnë të drejten e konkurimit në konkurs brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.
- Aplikacionet për konkurrim merren dhe dorëzohen në Drejtoratin për Arsim në Deçan.

Drejtori,
Qazim Maloku